



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1013/23 Datë: 26/07/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, mori:

V E N D I M

- I. Rikreditohen/Akreditothen programet e studimeve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
 1. *Ekonomiks BSc, 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik;*
 2. *Ekonomiks MSc, 120 ECTS (R), me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
 3. *Marketing BSc, 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 200 studentë për vit akademik;*
 4. *Kontabilitet BSc, 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik;*
 5. *Kontabilitet MSc, 120 ECTS (A), me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
 6. *Banka dhe Financa BSc, 180 ECTS (R), me kuotën maksimumi 300 studentë për vit akademik;*
 7. *Banka dhe Financa MSc, 120 ECTS (R), me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
- II. Akreditohet programi i studimit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën një (1) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2024):
 1. *Marketing MSc, 120 ECTS (R), me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshime të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I dhe II, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim/ Riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Ekonomiks BSc 180 ECTS (R)</i>	Luljeta Elezaj Nagip Skenderi Lekë Pula
2.	<i>Ekonomiks MSc 120 ECTS (R)</i>	Adriatik Hoxha Mjellma Carabregu Vokshi
3.	<i>Marketing BSc 180 ECTS (R)</i>	Fatos Ukaj Hykmete Bajrami Vjosa Fejza Ademi
4.	<i>Kontabilitet BSc 180 ECTS (R)</i>	Muhamet Aliu Hysen Ismajli Edona Perjuci
5.	<i>Kontabilitet MSc 120 ECTS (A)</i>	Nexhmije Berisha Vokshi Arben Hoti
6.	<i>Banka dhe Financa BSc 180 ECTS (R)</i>	Driton Balaj Arban Sahiti Alban Elshani
7.	<i>Banka dhe Financa MSc 120 ECTS (R)</i>	Valentin Toçi Albulena Shala
8.	<i>Marketing MSc 120 ECTS (R)</i>	Visar Rustemi Besnik Krasniqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Ekonomiks BSc 180 ECTS (R)*, vizita është organizuar më 27.03.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Reiner Harms dhe Domagoj Svigir, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht tre (3), Pjesërisht tre (3) standarde.
2. Për programin e studimit *Ekonomiks MSc 120 ECTS (R)*, vizita është organizuar më 28.03.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Reiner Harms dhe Domagoj Svigir, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht tre (3), Pjesërisht tre (3) standarde.

3. Për programin e studimit Marketing BSc 180 ECTS (R), vizita është organizuar më 30.03.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Dražen Vrhovski dhe Asnate Kazoka. KSHC ka marrë për bazë RVV e programit, raportin e ekipit vlerësues, raportet e ekspertëve ndërkombëtarë në shtatë programet tjera të të njëjtit fakultet (Fakultetit Ekonomik), të cilat për këto standarde: 'infrastrukturën e resurset', 'përmbajtjen e procesit arsimor' dhe 'menaxhimin e cilësisë', janë vlerësuar së paku substancialisht nga ekspertët ndërkombëtarë të fushës. Duke marrë për bazë këto, KSHC vendosi për akreditimin e këtij programi.
4. Për programin e studimit Kontabilitet BSc 180 ECTS (R), vizita është organizuar më 04.04.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Mirjana Hladika dhe Juraj Bogat, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5), Substancialisht një (1) dhe Pjesërisht një (1) standarde.
5. Për programin e studimit Kontabilitet MSc 120 ECTS (A), vizita është organizuar më 05.04.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Mirjana Hladika dhe Juraj Bogat, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) standarde.
6. Për programin e studimit Banka dhe Financa BSc 180 ECTS (R), vizita është organizuar më 13.04.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Natalia Gurvits dhe Alicia Presencio Herrero, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht katër (4), Pjesërisht një (1) standarde.
7. Për programin e studimit Banka dhe Financa MSc 120 ECTS (R), vizita është organizuar më 14.04.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Natalia Gurvits dhe Alicia Presencio Herrero, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht katër (4), Pjesërisht dy (2) standarde.
8. Për programin e studimit Marketing MSc 120 ECTS (R), vizita është organizuar më 30.03.2023, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis dhe Domagoj Svigir, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht tre (3), Pjesërisht tre (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtoj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 882/24 Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Rikreditohen/Akreditohen programet e studimeve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Menaxhment, BSc 180, me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik;*
 2. *Menaxhment, MSc 120, me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik;*
 3. *Marketing, MSC 120, me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshime të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim/ Riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	Management, BSc 180	Gentrit Berisha Albana Berisha Qehaja Veton Zeqiraj
2.	Management, MSC 120	Besnik Krasniqi Lura Rexhepi
3.	Marketing, MSC 120	Visar Rustemi Vjosa Fejza Ademi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Menaxhment BSc 180, vizita është organizuar më 08.03.2024, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis, Razaq Raj dhe Arnoldas Solovjivas, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) ndërsa Pjesërisht dy (2) fusha.
2. Për programin e studimit; Menaxhment, MSC 120, vizita është organizuar më 08.03.2024, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis, Razaq Raj dhe Arnoldas Solovjivas, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht pesë (5) ndërsa Pjesërisht dy (2) fusha.
3. Për programin e studimit; Marketing, MSC 120, vizita është organizuar më 08.03.2024, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis dhe Razaq Raj dhe Arnoldas Solovjivas, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht katër (4), ndërsa Pjesërisht tre (3) fusha.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 122-të, të mbajtur më datë 22.04.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrij ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

